

FORMULARI NUMËR 3

KONCEPTDOKUMENTI PËR KRYEPROKUROR

Emri:	SHKELZEN
Mbiemri:	IBRAHIMI

Bazuar në kompetencat ligjore të parapara për pozitën që aplikoni, ju lutem të ofroni si vijon:

I. Analizën tuaj:

1. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në Prokurorinë e Shtetit?
2. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në prokurorinë për të cilën keni aplikuar?
3. Cilat janë mangësitë dhe sfidat kryesore të kësaj prokurorie?
4. A mendoni se strategjitë aktuale të sistemit adresojnë nevojat e prokurorisë për të cilën aplikoni si Kryeprokuror?

1. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në Prokurorinë e Shtetit?

Në cilësi të Zëvendës-kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit, me mbi 14 vite përvojë pune si Prokuror i shtetit dhe doktor shkencash në fushën e drejtësisë penale, vlerësoj se Prokuroria e Shtetit ka bërë hapa të rëndësishëm drejt përmirësimit dhe modernizimit të sistemit në përgjithësi që kanë ndikim afatgjatë siç janë: dekretimi i prokurorëve të rinj, të gjithë me potencial të lartë dhe energji të re, është një hap strategjik për të garantuar vazhdimësinë dhe për të siguruar një staf të përkushtuar dhe të përgatitur për sfidat e të ardhmes; implementimi i sistemit SMIL për menaxhimin e lëndëve ka rritur ndjeshëm efikasitetin dhe transparencën në trajtimin e rasteve, duke përmirësuar qasjen ndaj të dhënave dhe monitorimin e rrjedhës së punës; rritja e numrit të trajnimeve për prokurorët dhe stafin kontribon në përmirësimin e vazhdueshëm të aftësive profesionale, duke ndikuar kështu pozitivisht në cilësinë e punës dhe profesionalizmin e përgjithshëm në prokurori.

Megjithatë edhe përkundër faktit se është rritur numri i prokurorëve dhe me Kodin Penal në fuqi është rritur afati i parashkrimit të ndjekjes të veprave penale, në disa prokurori është mungesë e numrit të prokurorëve përfshirë edhe të stafit mbështetës, gjë që ka ndikuar në vonesa në trajtimin e lëndëve, rrjedhimisht ndikon edhe në perceptimin publik për efikasitetin e prokurorisë në përgjithësi. Sfidë është ende transparenca e plotë e procedurave dhe krijimi i mekanizmave për llogaridhënie, e cila është e rëndësishme për të ruajtur besimin e publikut.

Po ashtu është e nevojshme modernizimi i infrastrukturës teknologjike, ngase do të ndikonte në lehtësimin e punëve të përditshme si të prokurorëve ashtu edhe të punëtorëve administrativ.

Një nga çështjet më kritike që lidhen me gjendjen e tanishme është sigurimi i pavarësisë së plotë të prokurorisë, duke u mbrojtur nga ndikimet dhe presionet e jashtme, gjë që kërkon në vazhdimësi vëmendje dhe njëkohësisht angazhim për të ruajtur besimin e publikut në sistemin prokurorial.

2. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në prokurorinë për të cilën keni aplikuar?

Prokuroria e Apelit aktualisht është duke u përballë me një sfidë të konsiderueshme për shkak të numrit të madh të lëndëve që janë duke u trajtuar. Krahasuar me ngarkesën e punës numri i prokurorëve po ashtu edhe i stafit mbështetës është relativisht i vogël, gjë që është duke krijuar presion të lartë për secilin prej tyre. Megjithatë, është për t'u vlerësuar fakti që, pavarësisht kësaj situatë të vështirë, të gjitha lëndët, përfshirë edhe ato të natyrës urgjente, përfundohen brenda afateve të caktuara ligjore. Kjo dëshmon përkushtimin dhe profesionalizmin e prokurorëve, mirëpo kjo gjendje është ngarkesë e vazhdueshme dhe sfiduese për prokurorinë e Apelit. Në këtë drejtim konsideroj se kontributi im në cilësinë e zëvendës kryeprokurorit ka ndikuar në përmirësimin e organizimit të brendshëm të prokurorisë, kjo për shkak siç është theksuar më lartë janë trajtuar të gjitha lëndët brenda afateve të parapara ligjore edhe përkundër numrit të vogël si të prokurorëve e edhe të stafit administrativ.

Për të ruajtur standardet e larta dhe për të shmangur ndikimin negativ për shkak të mbingarkesës, konsideroj se është e nevojshme rritja e numrit të prokurorëve dhe stafit mbështetës në këtë prokurori. Në këtë drejtim është e nevojshme edhe organizimi i trajnimeve të specializuara për rastet më komplekse për të garantuar cilësinë e vendimeve, veçanërisht për shkak të ndryshimeve me hyrjen në fuqi të kodit të ri të procedurës penale dhe të instituteve të reja, si ankesa ndaj aktvendimit për hedhje të kallëzimit penal, ankesa ndaj aktvendimit për pushim të hetimeve, e po ashtu edhe ankesa e drejtpërdrejt në Prokurorinë e Apelit e të dëmtuarit/viktimës ndaj dështimit të prokurorit të PTH/Speciales që të ndër marr veprime.

3. Cilat janë mangësitë dhe sfidat kryesore të kësaj prokurorie?

Prokuroria e Apelit është duke u përballë me disa mangësi dhe sfida kryesore që ndikojnë në funksionimin e saj. Ndër sfidat më të mëdha siç është theksuar më lartë është numri i madh i lëndëve që duhet trajtuar në krahasim me numrin e prokurorëve si në Departamentin e përgjithshëm, Departamentin e Krimeve të Rënda e po ashtu edhe në Departamentin për të Mitur. Numri i prokurorëve dhe i stafit mbështetës është i pamjaftueshëm për të përballuar fluksin e lëndëve, gjë që krijon një mbingarkesë në punë. Në këtë drejtim duke qenë se numri i madh i lëndëve janë të natyrës urgjente dhe trajtimi i tyre kërkon përkushtim maksimal për

përfundimin e tyre brenda afateve ligjore, rritë presionin tek prokurorëve rrjedhimisht edhe tek stafi mbështetës, ndërsa kjo mbingarkesë mund të ndikojë në cilësinë e vendimeve dhe të rritë rrezikun për gabime apo edhe vonesa në trajtimin e lëndëve.

Një tjetër sfidë është mungesa e mjeteve të avancuara teknologjike dhe logjistike, të cilat do të mund të lehtësonin proceset e punës dhe të përmirësonin efikasitetin. Sfidat e vazhdueshme në mbështetjen teknike dhe në trajnimin e specializuar po ashtu ndikojnë në zhvillimin profesional të stafit dhe në përballimin efektiv të rasteve komplekse.

Si zëvendës kryeprokuror Prokurorinë e Apelit, me përvojë pune me mbi 14 vjet në cilësi të Prokurorit të shtetit dhe doktor shkence në fushën penale, kam pasur mundësinë të vërej dhe të përjetoj nga afër sfidat dhe mangësitë me të cilat përballlet Prokuroria e Apelit. Disa nga sfidat kryesore që vlerësoj janë si vijon:

Një nga problemet kryesore që përballen prokurorët e Apelit është ngarkesa e lartë e çështjeve që trajtohen në këtë prokurori, e cila mund të çojë në vonesa të konsiderueshme në procesin e vendimmarrjes në Prokurorinë e apelit, rrjedhimisht edhe në Gjykatën e Apelit, por edhe në prokurorit themelore dhe atë Speciale. Kjo ngarkesë e lëndëve mund të dëmtojë efektivitetin e sistemit të drejtësisë dhe të rrisë shqetësimet e publikut lidhur me cilësinë e vendimeve në Prokurorinë e Apelit.

Pavarësia e Prokurorisë së Apelit, si pjesë e sistemit të drejtësisë, mbetet një shqetësim i vazhdueshëm, sidomos përballë mundësive të ndikimit nga faktorë të jashtëm, si presionet mediatike dhe ato nga shoqëria civile. Sigurimi i një ambienti të paanshëm dhe të paprekur nga këto ndikime është thelbësor për ruajtjen e besimit të publikut.

Përballë këtyre sfidave, kam një vizion të qartë për forcimin e Prokurorisë së Apelit përmes investimeve në trajnime të vazhdueshme, modernizimin e infrastrukturës dhe përmirësimin e kushteve të punës për stafin. Po ashtu, do të angazhohem për të promovuar një kulturë të transparencës dhe të paanshmërisë, dhe për të forcuar marrëdhëniet ndër-institucionale, me qëllim që të sigurohet një sistem i drejtësisë i shpejtë, i efektshëm dhe i besueshëm.

4. A mendoni se strategjitë aktuale të sistemit adresojnë nevojat e prokurorisë për të cilën aplikoni si Kryeprokuror?

Strategjitë aktuale të sistemit përmbajnë disa elemente të rëndësishme për Prokurorinë e Apelit, mirëpo konsideroj e të njëjtat nuk i adresojnë të gjitha nevojat kjo për shkak të rritjes së numrit të lëndëve që duhet trajtuar. Strategjitë ekzistuese janë të fokusuara kryesisht në përmirësimin e efikasitetit dhe transparencës, që kontribuon lehtësimin e punëve të përditshme në Prokurori. Duke marrë parasysh

numrin e madh të lëndëve që pranohen çdo ditë është më se e nevojshme rritja e numrit të prokurorëve dhe përmirësimi i mëtejshëm në infrastrukturën teknologjike në mënyrë që të lehtësohet punën e prokurorëve dhe për të siguruar një menaxhim më të mirë të të dhënave.

Po ashtu, për të përmbushur standardet më të larta në trajtimin e çështjeve të ndërlikuara, strategjitë duhet të përfshijnë programe më intensive për trajnimin dhe specializimin e prokurorëve. Kjo është një mundësi për të siguruar një standard të lartë profesional dhe integriteti në proceset ligjore. Njëkohësisht është po ashtu e nevojshme që strategjitë të përfshijnë plane të qarta për të përmirësuar kushtet e punës për trajtimin efektiv të lëndëve me prioritet të lartë.

Si kryeprokuror, do të angazhohem që të kërkoj përmirësime në strategji për të siguruar që Prokuroria e Apelit të ketë burimet dhe mbështetjen e duhur për të përmbushur me sukses përgjegjësitë e saj.

Konsideroj se përvoja ime e gjatë si prokuror dhe aktualisht në rolin e zëvendës kryeprokurorit, përfshirë edhe studimet e mia të thelluara në fushën e drejtësisë penale si brenda vendit ashtu edhe në Shtetet e Bashkuara më japin një perspektivë të gjerë për vlerësimin e strategjisë aktuale të sistemit prokurorial. Me këtë sfond kam një kuptim të thellë të nevojave të veçanta të Prokurorisë të Apelit dhe kam njohuri të vlerësoj nëse këto strategji janë të përshtatshme për ti përmbushur kërkesat dhe sfidat me të cilën përballlet kjo prokurori.

Aktualisht, është duke u zhvilluar një fokus i qartë në përmirësimin e menaxhimit të çështjeve dhe procesin e administrimit të rasteve. Megjithatë, ngarkesa e madhe e çështjeve dhe cilësia e vendimeve mbeten një shqetësim. Ndërsa janë bërë përpjekje për të adresuar këtë, implementimi i një infrastrukture më të fortë teknologjike dhe menaxhimi më i avancuar i çështjeve është një prioritet që kërkon vëmendje të mëtejshme.

Strategjitë për zhvillimin e kapaciteteve profesionale të prokurorëve janë të dobishme, por ndoshta nuk janë të mjaftueshme për t'u përballur me sfidat e natyrës gjithnjë e më komplekse të çështjeve që kalojnë nëpër Prokurorinë e Apelit. Për të përmirësuar cilësinë e punës dhe për të siguruar që prokurorët të jenë të aftë për të trajtuar çështje të ndërlikuara, është e nevojshme të investohet më shumë në trajnime të avancuara për zhvillim profesional të vazhdueshëm. Kjo është një mundësi për të siguruar një standard të lartë profesional dhe integriteti në proceset ligjore.

Strategjitë aktuale synojnë të forcojnë pavarësinë e Prokurorisë së Apelit, gjë që është tepër e rëndësishme për ruajtjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Megjithatë, ndikimi nga faktorë të jashtëm, përfshirë presionet mediatike, vazhdon të mbetet një shqetësim.

Strategjitë që fokusohen në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional janë të rëndësishme, por shpeshherë implementimi i tyre nuk është i mjaftueshëm. Koordinimi më i ngushtë mes Prokurorisë së Apelit dhe institucioneve të tjera të drejtësisë si gjykatat, prokurorit themelore dhe ajo Speciale dhe agjencitë ndërkombëtare është kyç për të siguruar një proces të shpejtë dhe të drejtë.

Përfundimisht, strategjitë aktuale për Prokurorinë e Apelit përmbajnë disa elemente të dobishme, por kërkojnë përmirësime të mëtejshme për të adresuar sfidat e mëdha që përballen prokurorët. Si Kryeprokuror i Prokurorisë së Apelit, do të angazhohem për përmirësimin e vazhdueshëm të këtyre strategjive, duke forcuar burimet, modernizuar infrastrukturën dhe garantuar një proces të drejtë dhe të paanshëm, i cili është kyç për mbështetje të publikut dhe për ruajtjen e besimit në sistemin prokurorial.

II. Vizioni juaj për përmirësimin e punës operative në prokurorinë që keni aplikuar?

Ju lutem listoni/përmendni veprimet tuaja afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata:

1. Cili është vizioni juaj për të përmirësuar punën operative gjatë mandatit tuaj?
2. Cilat janë objektivat tuaja kryesore?
3. Cilat janë sfidat që prisni gjatë përmbushjes së këtyre objektivave?
4. Si do t'i tejkalonit ato?

1. Cili është vizioni juaj për të përmirësuar punën operative gjatë mandatit tuaj?

Vizioni im si kryeprokuror i Prokurorisë së Apelit është të krijoj një institucion që punon me efikasitet të lartë, profesionalizëm të lartë dhe transparencë, duke përmbushur detyrimet në mënyrë të plotë. Për të përmirësuar punën e prokurorisë, do të përqendrohem në disa drejtime kryesore. Fillimisht do të angazhohem për të rritur numrin e prokurorëve dhe të stafit mbështetës, për të lehtësuar mbingarkesën dhe për të përmirësuar trajtimin e lëndëve. Së dyti, do të angazhohem në organizimin e trajnimeve veçanërisht trajnime të specializuara si për prokurorët ashtu edhe stafin, duke siguruar që të njëjtit të kenë avancojnë njohurit për të trajtuar lëndët komplekse me efikasitet dhe profesionalizëm. Po ashtu ndër prioritetet e mija do të jetë përmirësimi i infrastrukturës teknologjike, duke lehtësuar përdorimin e sistemit SMIL dhe po ashtu do të angazhohem për të rritur transparencën dhe llogaridhënien në të gjitha proceset, duke vendosur standarde të qarta për zgjidhjen e lëndëve dhe për komunikimin e hapur me publikun.

Në tërësi, vizioni im është të ndërtoj një Prokurori të Apelit që jo vetëm plotëson detyrimet e saj ligjore, por që gjithashtu përmbush pritshmërinë e qytetarëve për drejtësi të drejtë, të shpejtë dhe të pandikuar

2. Cilat janë objektivat tuaja kryesore?

Objektivat kryesore të mandatit tim si kryeprokuror i Prokurorisë së Apelit janë:

1. përmirësimi i efikasitetit dhe menaxhimit të lëndëve,
2. rritja e kapaciteteve profesionale;
3. përmirësimi i infrastrukturës teknologjike;
4. rritja e transparencës dhe llogaridhënies;
5. sigurimi i pavarësisë dhe paanshmërisë në punën e prokurorisë;

Këto janë objektivat kyçe që do të drejtojnë punën time dhe që do të sigurojnë një Prokurori të Apelit që funksionon me efikasitet, besueshmëri dhe profesionalizëm.

3. Cilat janë sfidat që prisni gjatë përmbushjes së këtyre objektiveve?

Gjatë përmbushjes së këtyre objektiveve, pres disa sfida të rëndësishme që mund të ndikojnë në realizimin e planifikimeve. Disa prej sfidave kryesore janë:

1. Mungesa e prokurorëve dhe stafit administrativ;
2. Mungesa e infrastrukturës dhe mjeteve teknologjike;
4. Mungesa e trajnimeve të përshtatshme dhe të mjaftueshme për stafin;
5. Rritja e besimit dhe bashkëpunimi me publikun.

4. Si do t'i tejkalojnë ato?

Për të tejkaluar këto sfida do të angazhohem që të kem komunikim të rregullt me prokurorët dhe stafin administrativ, po ashtu do të kem komunikim të hapur me publikun dhe mediat, duke ofruar informacion të qartë dhe të saktë për proceset dhe rezultatet e punës së Prokurorisë.

III. Vizioni për të menaxhuar personelin në sistemin prokurorial

Ju lutem renditni hapat konkretë që do t'i ndërmerrenit gjatë mandatit tuaj:

1. Cili është modeli juaj në menaxhimin e stafit?
2. Si planifikoni ndarjen e barabartë të punës për stafin?
3. Si planifikoni të përmirësoni llogaridhënien dhe profesionalizmin e stafit?

1. Cili është modeli juaj në menaxhimin e stafit?

Modeli im i menaxhimit të stafit bazohet në transparencë, bashkëpunim dhe mbështetje. Do të krijoj një mjedis të hapur dhe të sigurt, ku çdo anëtar i stafit mund të kontribuoni me ide dhe shqetësime, ndërsa do të siguroj mbështetje të vazhdueshme për zhvillimin profesional dhe menaxhimin e ngarkesës.

Modeli im në menaxhimin e stafit bazohet në një qasje të hapur dhe gjithë përfshirëse. Unë besoj se një lider duhet të krijojë një ambient ku çdo anëtar i stafit ndjehet i vlerësuar dhe i motivuar, dhe këtë do ta bëja, duke bërë: organizim të takimeve të rregullta për të diskutuar sfidat dhe arritjet, ofroja mundësi për trajnim dhe zhvillim të vazhdueshëm për të gjithë stafin, si dhe do të inkurajoja stafin të marrë përgjegjësi dhe të kontribuoni në vendimmarrje.

2. *Si planifikoni ndarjen e barabartë të punës për stafin?*

Ndarja e barabartë e punës do të bazohet në aftësitë dhe përvojën e çdo anëtari të stafit, duke siguruar që lëndët të shpërndahen në mënyrë të drejtë dhe të efektshme. Do të krijoj një sistem monitorimi për të ndjekur ngarkesën dhe për të siguruar që asnjë prokuror apo staf mbështetës të mos mbingarkohet.

3. *Si planifikoni të përmirësoni llogaridhënien dhe profesionalizmin e stafit?*

Do të zhvilloj procedura të qarta dhe të transparencës për monitorimin e performancës, duke vendosur kritere të matshme dhe duke ofruar opinione të rregullta. Gjithashtu, do të inkurajoj trajnime të vazhdueshme për të rritur aftësitë profesionale dhe për të promovuar etikën dhe profesionalizmin në çdo aspekt të punës.

IV. Hapat që do të ndërmerrni për përmirësimin e integritetit dhe llogaridhënies së sistemit, prokurorisë dhe besimit të publikut?

Ju lutem listoni/përmendni veprimet tuaja afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata:

1. Çfarë hapash do të ndërmerrni për të ngritur nivelin e besueshmërisë në Prokurorinë tuaj, duke vënë baraspeshë mes transparencës dhe konfidencialitetit të procedurës?
2. Cilat janë planet tuaja për të siguruar punë cilësore në Prokurorinë tuaj?
3. Cilat janë planet tuaja për përmirësimin e llogaridhënies së përgjithshme në Prokurorinë tuaj?

1. *Çfarë hapash do të ndërmerrni për të ngritur nivelin e besueshmërisë në Prokurorinë tuaj, duke vënë baraspeshë mes transparencës dhe konfidencialitetit të procedurës?*

Do të krijoj një politikë të qartë për transparencën që respekton ndjeshmërinë e informacionit, duke siguruar që informacionet e rëndësishme të jenë të disponueshme për publikun, por gjithashtu duke mbrojtur të dhënat dhe sekretet që lidhen me procedurat. Do të angazhohem për komunikim të hapur dhe raportim të rregullt pa cenuar konfidencialitetin e rasteve.

2. Cilat janë planet tuaja për të siguruar punë cilësore në Prokurorinë tuaj?

Unë do të angazhohem në zhvillimin e kapaciteteve profesionale të stafit administrativ përmes trajnimeve. Po ashtu, do të rris angazhimin për menaxhimin efikas të lëndëve, duke siguruar që çdo lëndë të trajtohet sipas prioritetit.


3. Cilat janë planet tuaja për përmirësimin e llogaridhënies së përgjithshme në Prokurorinë tuaj?

Do të krijoj një sistem për monitorimin e punës dhe do të siguroj raporte të rregullta për të vlerësuar performancën e Prokurorisë në përgjithësi si dhe do të ketë transparencë për llogaridhënie për punën e prokurorisë.

Konceptdokumenti nuk duhet të përmbajë më shumë sesa 10 faqe me shkrimin e llojit Book Antiqua, madhësia 12, hapësira njëshe.

Deklaroj se përmbajtjen e këtij konceptdokumenti e kam përgatitur vetë dhe jam në dijeni se i njëjti do të publikohet në uebportal.

Nënshkrimi: _____



Datë: _____

08/11/2024